




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 5 paragrafi (2) neni 6 neni 26 paragrafi (1) nën paragrafi (1.1), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2023, miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 11/2023 PËR PËRJASHTIM GRUPOR TË KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE NË SEKTORIN E AUTOMJETEVE

Neni Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ përcakton kushtet që duhet të përmbajnë marrëveshjet vertikale ndërmjet ndërmarrjeve aktive në sektorin e automjeteve motorike, si dhe kushtet që këto marrëveshje nuk duhet të përmbajnë për t'u përjashtuar nga ndalesa e përgjithshme e nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji).

Neni 2 Përkufizimet

1. Për qëllimet e këtij Udhëzimi Administrativ, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - 1.1. **'marrëveshje vertikale'** do të thotë një marrëveshje ose praktikë e bashkërenduar e lidhur ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, secila prej të cilave operon, për qëllimet e marrëveshjes ose praktikës së bashkërenduar, në një nivel të ndryshëm të zinxhirit të prodhimit ose shpërndarjes, dhe në lidhje me kushtet sipas të cilave palët mund të blejnë, shesin ose rishesin mallra ose shërbime të caktuara;
 - 1.2. **'kufizim vertikal'** nënkupton kufizimin e konkurrencës në një marrëveshje vertikale që hyn në objektin e nenit 5 të ligjit;
 - 1.3. **'riparues i autorizuar'** nënkupton ofruesin e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes për mjetet motorike që operojnë brenda sistemit të shpërndarjes të krijuar nga një furnizues i automjeteve motorike;
 - 1.4. **'distributor i autorizuar'** është një shpërndarës (distributor) i pjesëve rezervë për automjetet motorike që operojnë brenda sistemit të shpërndarjes (distribuimit) të krijuar nga një furnizues i automjeteve motorike;
 - 1.5. **'riparues i pavarur'** nënkupton:
 - 1.6. një ofrues i shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes për automjetet motorike që nuk operojnë brenda sistemit të distribuimit të krijuar nga furnizuesi i automjeteve motorike për të cilat ai ofron riparime ose mirëmbajtje;
 - 1.7. një riparues i autorizuar brenda sistemit të shpërndarjes të një furnizuesi të caktuar, në masën që ofron shërbime riparimi ose mirëmbajtjeje për automjetet motorike në lidhje me të cilat nuk është anëtar i sistemit të distribuimit së furnizuesit përkatës;

1.8. **'distributor i pavarur'** nënkupton:

1.8.1. një distributor i pjesëve rezervë për automjetet motorike që nuk operojnë brenda sistemit të distribuimit të krijuar nga furnizuesi i automjeteve motorike për të cilat distribuon pjesë rezervë;

1.8.2. një distributor i autorizuar brenda sistemit të shpërndarjes së një furnizuesi të caktuar, në masën që distribuon pjesë rezervë për mjetet motorike në lidhje me të cilat nuk është anëtar i sistemit të distribuimit të furnizuesit përkatës;

1.9. **'automjet motorik'** nënkupton një mjet vetëlëvizës i destinuar për përdorim në rrugë publike dhe që ka tre ose më shumë rrota në rrugë;

1.10. **'pjesë këmbimi'** nënkupton mallrat që do të instalohen në ose mbi një mjet motorik në mënyrë që të zëvendësojnë komponentët e atij automjeti, duke përfshirë mallrat si lubrifikantët që janë të nevojshëm për përdorimin e një automjeti motorik, me përjashtim të karburantit;

1.11. **'sistem selektiv i distribuimit'** nënkupton një sistem distribuimi ku furnizuesi merr përsipër të shesë mallrat ose shërbimet e kontratës, drejtpërdrejt ose tërthorazi, vetëm distributorëve të zgjedhur në bazë të kriterëve të specifikuar dhe ku këta distributorë marrin përsipër të mos shesin mallra ose shërbime të tilla tek distributorët e paautorizuar brenda territorit të rezervuar nga furnizuesi për të operuar atë sistem.

2. Për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ, shprehjet 'ndërmarrje', 'furnizues', 'prodhues' dhe 'blerës' do të përfshijnë ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura.

'Ndërmarrje të lidhura' nënkupton:

2.1. ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshje, drejtpërdrejt ose tërthorazi:

2.1.1. ka kompetencën për të ushtruar më shumë se gjysmën e të drejtave të votës; ose

2.1.2. ka kompetencën për të emëruar më shumë se gjysmën e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen; ose

2.1.3. ka të drejtë të menaxhojë punët e ndërmarrjes;

2.2. ndërmarrjet të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë, mbi një palë në marrëveshje, të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën 2.1;

2.3. ndërmarrjet në të cilat një ndërmarrje e përmendur në pikën 2.2 ka drejtpërdrejt ose tërthorazi të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën 2.1;

2.4. ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshje së bashku me një ose më shumë nga ndërmarrjet e përmendura në pikat 2.1, 2.2 ose 2.3, ose në të cilat dy ose më shumë nga këto të fundit, së bashku kanë të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën 2.1;

2.5. ndërmarrjet në të cilat të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën 2.1 mbahen bashkërisht nga: 2.1.1 palët në marrëveshje ose ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura, të përmendura në pikat 2.1 deri në 2.4 ose 2.1.2 një ose më shumë nga palët në marrëveshje ose një ose më shumë nga ndërmarrjet e tyre të lidhura të përmendura në pikat 2.1 deri në 2.4 dhe një ose më shumë palë të treta.

Neni 3

Përjashtimi

Në pajtim me nenin 5.2 të Ligjit dhe duke i'u nënshtuar dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ, neni 5.1 i Ligjit nuk zbatohet për marrëveshjet vertikale që kanë të bëjnë me kushtet në të cilat palët mund të blejnë, shesin ose rishesin pjesë këmbimi për automjete

motorike ose të ofrojnë riparime dhe shërbime të mirëmbajtjes së automjeteve motorike, të cilat plotësojnë kushtet për përjashtim sipas Udhëzimit Administrativ për përjashtimet në bllok të marrëveshjeve vertikale të ndërmarrjeve Nr. 06/2023 dhe nuk përmbajnë asnjë nga klauzolat e forta të renditura në nenin 3 të këtij Udhëzimi Administrativ. Ky përjashtim do të zbatohet për aq sa këto marrëveshje përmbajnë kufizime vertikale.

Neni 4

Kufizimet që heqin përfitimin e përjashtimit në grup – kufizimet e rënda

1. Përjashtimi i parashikuar në nenin 2 nuk zbatohet për marrëveshjet vertikale të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi të izoluara ose në kombinim me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë si objekt:

1.1. kufizimin e shitjeve të pjesëve rezervë për automjete motorike nga anëtarët e një sistemi selektiv të distribuimit tek riparuesit e pavarur që i përdorin ato pjesë për riparimin dhe mirëmbajtjen e një automjeti;

1.2. kufizimin e rënë dakord ndërmjet një furnizuesi të pjesëve rezervë, mjeteve të riparimit ose pajisjeve diagnostikuese ose të tjera dhe një prodhuesi të mjeteve motorike, të aftësisë së furnitorit për t'i shitur ato mallra distributorëve të autorizuar ose të pavarur ose riparuesve të autorizuar ose të pavarur ose përdoruesve fundorë;

1.3. kufizimin e rënë dakord ndërmjet një prodhuesi të automjeteve motorike i cili përdor komponentë për montimin fillestar të mjeteve motorike dhe furnizuesit të këtyre komponentëve, të aftësisë së furnitorit për të vendosur markën ose logon e tij në mënyrë efektive dhe lehtësisht të dukshme mbi komponentët e furnizuar ose në pjesë këmbimi.

Neni 5

Tërheqja në raste individuale

1. Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës mund të tërheqë përfitimin nga ky Udhëzim Administrativ, në pajtim me nenin 6 të Ligjit, kur konstaton në ndonjë rast të veçantë se një marrëveshje vertikale për të cilën zbatohet përjashtimi i paraparë në nenin 2 të këtij Udhëzimi Administrativ ka, megjithatë, efekte të cilat janë të papajtueshme me paragrafin 2 të nenit 5 të Ligjit.

2. Në përcaktimin nëse përfitimi nga ky Udhëzim Administrativ duhet të tërhiqet në bazë të nenit 6 të Ligjit, efektet anti-konkurrese që mund të rrjedhin nga ekzistenca e rrjeteve paralele të marrëveshjeve vertikale që kanë efekte të ngjashme që kufizojnë ndjeshëm qasjen në një treg përkatës ose konkurrencën në të, janë të një rëndësie të veçantë. Efekte të tilla kumulative mund të lindin, për shembull, në rastin e distribuimit selektiv ose të detyrimeve për të mos-konkurruar.

Neni 6

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


Nejme Binaku-Isufi
Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës